



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT
TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË MENAXHIMIT FINANCIAR,
KONTROLLIT DHE KONTABILITETIT

Nr. 23597 Prot.

Tiranë, më 18/12/2020

URDHËR

Nr. 305, Datë 18.12 2020

**“PËR
MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE PËR ZHVILLIMIN E
MËTEJSHËM TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK 2021-
2022”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe bazuar në nenet: 6 dhe 26 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Dokumentit të Politikave për Zhvillimin e Mëtejshëm të Kontrollit të Brendshëm të Financiar Publik 2021-2022”, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Qëllimi i Dokumentit të Politikave për Zhvillimin e Mëtejshëm të Kontrollit të Brendshëm të Financiar Publik në Shqipëri për periudhën 2021 - 2022, është të sigurojë zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të vendosur të kontrollit të brendshëm, si një mjet që do të përdoret nga niveli drejtues për një menaxhim me përgjegjshmëri, sukses dhe transparent të fondeve kombëtare dhe të Bashkimit Evropian.
3. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij urdhri.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR


Anila Denaj

**Dokumenti i Politikave për Zhvillimin e Mëtejshëm të
Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik
2021 – 2022**

Tiranë, 2020

Shkurtime:

MFE- Ministria e Financave dhe Ekonomisë

KBFP- Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik

MFK- Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

KB-Kontrolli i Brendshëm

AB- Auditimi i Brendshëm

DPH / KBFP- Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik

DH / MFKK - Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar Kontrollit dhe Kontabilitetit

DH/AB - Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Strategjia e MFP-Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike

Strategjia e RAP - Strategjia e Reformës në Administratën Publike

BE-Bashkimi Evropian

GMS - Grupi i Menaxhimit Strategjik

KD MFP - Komiteti Drejtues i Menaxhimit të Financave Publike

KT MFP - Komiteti Teknik i Menaxhimit të Financave Publike

PËRMBAJTJE

I. HYRJE.....	4
II. OBJEKTIVAT DHE MASAT SPECIFIKE TË ZHVILLIMIT TË MËTEJSHËM TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK BAZUAR NË KOMPONENTËT E MFK-SË.....	6
2.1 Mjedisi i Kontrollit	6
2.1.1 Objektivi specifik 1: Mjedisi efektiv i kontrollit.....	6
2.1.2 Objektivi specifik 2: Forcimi i përgjegjshmërisë menaxheriale në njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe përgjegjshmëri e decentralizuar menaxheriale.....	8
2.1.3 Objektivi specifik 3: Përmirësimi i procesit të planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit në nivelin qendror dhe vendor, përmes rritjes së rolit të aktorëve të përfshirë në Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe Ekipin e Menaxhimit të Projektit (EMP).....	12
2.2 Menaxhimi i riskut.....	15
2.2.1 Objektivi specifik 4: Përcaktimi i mekanizmave të mirë-organizuar dhe funksional të procesit të menaxhimit të riskut.....	15
2.3 Informimi dhe komunikimi.....	17
2.3.1 Objektivi specifik 5: Përmirësimi i fushës së kontabilitetit të sektorit publik në Shqipëri	17
2.3.2 Objektivi specifik 6: Vendosja e një sistemi eficient dhe efektiv të informimit dhe komunikimit.....	20
2.4 Aktivitetet e kontrollit.....	21
2.4.1 Objektivi specifik 7: Aktivitete kontrollit nëpërmjet dokumentimit të sistemit të MFK përmes Hartës/manualeve të Proceseve të punës dhe Gjurmëve të Auditimit.....	21
2.5 Monitorimi	24
2.5.1 Objektivi specifik 8: Monitorimi dhe vlerësimi i përshtatshmërisë, efikasitetit dhe efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit	24
2.5.2 Objektivi specifik 9: Forcimi i rolit të një auditimi të brendshëm funksionalisht të pavarur në sektorin publik.....	26

III. ROLI DHE PËRGJEGJËSITË PËR MONITORIMIN DHE NDJEKJEN E ZBATIMIT TË DOKUMENTIT TË POLITIKAVE PËR ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM TË KBFP-SË. 30

Shtojca. 1. Plani i veprimit për zbatimin e Dokumentit të politikave për zhvillimin e mëtejshëm të kontrollit të brendshëm financiar publik të Shqipërisë për periudhën 2021 - 202231

I. HYRJE

Vizioni i Qeverisë, përmes Dokumentit të Politikave për Zhvillimin e Mëtejshëm të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Shqipëri për periudhën 2021 - 2022, është të sigurojë zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të vendosur të KBFP-së, si një mjet që duhet të përdoret nga drejtuesit dhe stafi i njësive për një menaxhim të përgjegjshëm, të suksesshëm dhe transparent të fondeve kombëtare dhe të BE-së. Qëllimi i këtij dokumenti është të përcaktojë kornizën e sistemit bashkëkohor, të përshtatshëm dhe të efektshëm të KBFP-së, duke përfshirë menaxhimin financiar dhe kontrollin, auditimin e brendshëm, njësinë qendrore të harmonizimit, si dhe të bashkëpunojë për një menaxhim të shëndosh financiar të fondeve publike në Republikën e Shqipërisë.

Me zbatimin e këtij Dokumenti të Politikave, Qeveria e Republikës së Shqipërisë parashikon të zbatojë KBFP-në në të gjithë sektorin publik dhe të mbulojë tre parimet thelbësore të KBFP-së: 1) përgjegjshmërinë e decentralizuar menaxheriale, të mbështetur nga sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK), 2) auditimi i brendshëm funksionalisht i pavarur (AB) dhe 3) harmonizimi i centralizuar i metodologjive dhe standardeve në lidhje me MFK-në dhe AB-në.

Megjithëse KBFP është një pjesë integrale e Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike të Shqipërisë (2019-2022) dhe baza ligjore e kësaj fushe është e plotësuar, nevojitet angazhim i mëtejshëm për të arritur një sistem të menaxhimit financiar dhe kontrollit plotësisht funksional në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Duke synuar që menaxherët të bëhen plotësisht të vetëdijshëm për rolin që luan kontrolli i brendshëm në sigurimin e menaxhimit të fortë dhe të qëndrueshëm të financave publike, zbatimi i këtij dokumenti të politikave do të përmirësojë funksionimin e sektorit publik duke parashtruar metoda të përshtatshme të planifikimit dhe raportimit financiar, tregues gjithëpërfshirës të performancës, si dhe mekanizma të efektshëm të kontrollit të brendshëm që do të sigurojnë shkallë të mjaftueshme sigurie për delegimin e detyrave dhe përgjegjësi. Duke vendosur theksin në përgjegjshmërinë e decentralizuar menaxheriale në të gjitha nivelet e të gjithë sektorit publik, menaxherët do të mund të zhvillojnë objektiva të përshtatshme dhe të efektshme për njësitë e tyre dhe në të njëjtën kohë do të marrin përgjegjësinë e plotë për veprimet dhe vendimet e tyre. Prandaj, në vend që të zhvillohet si një shtesë e sistemeve ekzistuese, përgjegjshmëria menaxheriale duhet të vendoset në zemër të proceseve të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit dhe në të gjitha sistemet e informacionit të buxhetit aktual dhe të ardhshëm. Duke vijuar në pajtueshmëri me

standardet ndërkombëtare, njësitë e auditimit të brendshëm do të mund të përmirësojnë mbështetjen që u japin menaxherëve në identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve. Prandaj, audituesit e brendshëm do të mund të vlerësojnë në mënyrë efektive sistemet e MFK-së dhe të japin rekomandime të përshtatshme për përmirësimin e mëtejshëm të njërive të tyre. Së fundmi, për të zgjeruar të gjithë sistemin dhe për të siguruar informacion të vazhdueshëm dhe të mjaftueshëm mbi ecurinë dhe gjendjen e të gjithë sistemit të kontrollit të brendshëm, do të krijohet një metodologji gjithëpërfshirëse e Vlerësimit të Cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm.

Përgjegjësia përfundimtare për krijimin dhe zhvillimin e kontrollit të brendshëm financiar publik qëndron tek drejtuesi i njësisë së sektorit publik. Drejtuesit janë përgjegjës për krijimin dhe sigurimin e një koncepti të përshtatshëm dhe efikas të KBFP-së që funksionon në të gjitha njësitë. Secili drejtues duhet të marrë përgjegjësinë e plotë për menaxhimin dhe kontrollin e fondeve të aprovuara nga buxheti, duke siguruar njëkohësisht zbatimin e verifikimit dhe mbrojtjes së përshtatshme. Niveli menaxherial duhet të përdorë sistemin e KBFP-së si një mjet për një menaxhim të përgjegjshëm, të suksesshëm dhe transparent të fondeve kombëtare dhe të BE-së. Për të arritur këtë, menaxherët duhet të jenë më të vetëdijshëm se si ky mjet mund t'i ndihmojë ata të menaxhojnë fondet në formën e kursimeve të shpenzimeve dhe në këtë mënyrë t'i ndihmojë në arritjen e objektivave të tyre.

Me zbatimin e këtij Dokumenti të Politikave, Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të ketë një instrument më shumë për përshpejtimin e negociatave të pranimit në BE-në për Kapitullin 32 - Kontrolli Financiar. Megjithatë nuk ka rregulla për përafrim në *Acquis* të BE-së për Kapitullin 32 / KBFP, vendet candidate duhet të reformojnë sistemin e tyre të kontrollit të brendshëm financiar publik në një mënyrë të tillë që të ndjekin dhe zbatojnë standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira të BE-së. Në këtë mënyrë, me qëllim të përfitimit të praktikave më të mira dhe zhvillimit të sistemeve të efektshme të kontrollit të brendshëm, vendi ynë përmes këtij dokumenti të politikave ndërmerr aktivitete intensive për krijimin dhe zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar në përputhje me rregulloren e BE-së. Kështu, krahasuar me strategjinë e menaxhimit të financave publike, ku zhvillimi i kontrollit të brendshëm është një nga shtyllat e kësaj strategjie, ky dokument i politikave ofron një mbulim më të gjerë të kësaj fushe, duke detajuar të gjitha masat, aktivitetet, treguesit e rezultateve që do të shërbejnë për zbatimin e këtij sistemi nga të gjithë njësitë e sektorit publik.

Dokumenti i Politikave për Zhvillimin e Mëtejshëm të Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik për vitet 2021–2022, bazohet në kolonën 1 të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 "Rritja përmes Stabilitetit Makro-Ekonomik dhe Fiskal" (NSDI), Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike (MFP) 2019-2022, objektivat specifik 2, 4, 5, 6, Strategjia e Reformës së Administratës Publike (RAP) 2015-2020, objektivi 10 dhe kuadri ligjor në këtë fushë.

Ky dokument do të përcaktojë të gjitha përparësitë, objektivat, aktivitetet, arritjet, sfidat, treguesit e performancës dhe planet e veprimit të Shqipërisë në fushën e sistemit të kontrollit të brendshëm publik, për periudhën 2021-2022. Afati kohor ndahet në periudhë afatshkurtër për 1 vit dhe

periudhë afatmesëm për 2 vjet. Për periudhën afatgjatë do të jetë e nevojshme zhvillimi i mëtejshëm i dokumentit. Dokumenti është i ndarë në tre kapituj: I - Hyrja, II - Objektivat specifike në përputhje me pesë komponentët COSO dhe III - Monitorimi. Plani i veprimit ndodhet bashkangjitur në aneksin e këtij dokumenti.

II. OBJEKTIVAT DHE MASAT SPECIFIKE TË ZHVILLIMIT TË MËTEJSHËM TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK BAZUAR NË KOMPONENTËT E MFK-SË.

Objektivat specifike të qeverisë për periudhën 2021-2022, të ndara në përputhje me pesë komponentët e MFK-së janë si më poshtë:

2.1 Mjedisi i Kontrollit

2.1.1 Objektivi specifik 1: Mjedisi efektiv i kontrollit

Një nga bazat e menaxhimit financiar dhe kontrollit është krijimi i strukturave të menaxhimit që duhet të sigurojnë se vendimet e miratuara janë të përshtatshme dhe zbatohen për të siguruar përdorim transparent të fondeve buxhetore të aprovuara. Në procesin e menaxhimit, vendimet kanë një dimension financiar, zbatimi i të cilave shkakton krijimin e detyrimeve, shpenzimet, si dhe mbledhjen e fondeve buxhetore. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të theksohet se menaxherët në nivele më të ulëta duhet të kenë objektiva të përcaktuara qartë, si dhe tregues të objektivave të arritshëm, duke përfshirë edhe parametrat financiarë. Kjo siguron një pasqyrë për menaxherët në nivele më të larta, me qëllim identifikimin nëse menaxherët në nivele më të ulëta përmbushin detyrat e deleguara dhe nëse ata janë të suksesshëm në arritjen e objektivave.

Qeveria është e angazhuar të mundësojë një mjedis kontrolli i cili do të vendosë mjedisin e organizimit, pasi ai është themeli për të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm, duke siguruar disiplinën dhe strukturën. Mjedisi i kontrollit përbëhet nga dy anë: strukturat formale dhe aspektet e sjelljes individuale; dhe të dy këto duhet të bashkëveprojnë. Niveli drejtues ka rolin kryesor në miratimin dhe mbështetjen e mjedisit të kontrollit.

Prandaj, një faktor i efektshëm i mjedisit të kontrollit përfshin integritetin, vlerën etike dhe kompetencën e stafit të njësisë; filozofinë dhe stilin e funksionimit të nivelit drejtues; mënyrën se si niveli drejtues cakton autoritetin dhe përgjegjësinë, dhe organizon dhe zhvillon stafin e saj, dhe vëmendjen dhe drejtimin e dhënë.

Treguesit e rezultateve:

- 75% e njësi publike të rishikuara gjatë periudhës së zbatimit mund të tregojnë se kanë realizuar aktivitetet e parashikuara në planet e tyre të veprimit të MFK-së, që janë krijuar për të trajtuar mangësitë e identifikuara në raportet vjetore;

- 75% e strukturave të financave të rishikuara gjatë periudhës së zbatimit të institucioneve publike mund të tregojnë se zbatimi i planit të tyre të veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit i ka ndihmuar të arrijnë në ruajtjen e një pjese të buxheti ose efikasitete të tjera për institucionin e tyre.

Masa 1: Përmirësimi i procesit të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit

Kjo masë do të mundësojë përmirësimin e kuadrit rregullator të nevojshëm për hartimin, miratimin dhe zbatimin e një sistemi rregullash, standardesh dhe procedurash që sigurojnë menaxhimin ekonomik, të efektshëm dhe efektiv të burimeve financiare publike.

Aktivitetet:

Aktiviteti 1.1.1: Rishikimi i pyetësorit të vetëvlerësimit, në mënyrë që të plotësohet në mënyrën e duhur nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme;

Institucionet përgjegjëse: MFE (DH/MFKK) , Njësitë e Qeverisjes Qendrore

Aktiviteti 1.1.2: Rishikimi i planit të veprimit të zhvillimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në mënyrë që të plotësohet në mënyrën e duhur nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Institucionet përgjegjëse: MFE (DH/MFKK), Njësitë e Qeverisjes Qendrore

Aktiviteti 1.1.3: Rishikimi i manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në mënyrë që të plotësohen dhe qartësohen ndryshimet e reja të sistemit.

Institucionet përgjegjëse: MFE (DH/MFKK)

Rezultati i pritshëm:

- 150 njësi që do të zbatojnë në praktikë të gjitha ligjet dhe aktet nën-ligjore të rishikuara në përputhje me kërkesat e MFK-së;
- 150 raporte vjetore të sakta në lidhje me kontrollin e brendshëm të dorëzuar në MFE.

Afati kohor: Aktiviteti 1.1.1 dhe Aktiviteti 1.1.2: Afatshkurtër

Aktiviteti 1.1.3: Afatmesëm

Masa 2: Forcimi i kapaciteteve të strukturave të financës në qeverisjen qendrore dhe vendore (në 10 institucione për asistencë teknike)

Zbatimi i një sistemi modern të menaxhimit financiar dhe kontrollit, përmes ofrimit të asistencës teknike për disa institucione të sektorit publik, do të mundësojë zbatimin rigoroz të kërkesave ligjore në fushën e kontrollit të brendshëm, zhvillimin e menaxhimit financiar dhe instrumenteve të kontrollit dhe standardizimin e procedurave kryesore të punës.

Kjo masë do të ndihmojë në rritjen e kapacitetit të këtyre njësive për të përftuar dhe zbatuar standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira, duke pasqyruar në periudha afatgjata sisteme të efektshme të kontrollit të brendshëm.

Aktivitetet:

Aktiviteti 1.2.1: Zhvillimi i planit të veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore, të përzgjedhura si institucione të cilave do t'u ofrohet asistencë teknike;

Institucionet përgjegjëse: Institucionet e përzgjedhura për asistencë teknike, MFE (DH / \MFKK) si mbështetje.

Aktiviteti 1.2.2: Zhvillimi i instrumenteve të MFK-së bazuar në kuadrin ligjor dhe nënligjor të MFK-së në njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore të përzgjedhura si institucione të përzgjedhura për asistencë teknike.

Institucionet përgjegjëse: Institucionet e përzgjedhura për asistencë teknike, MFE (DH/MFKK) si mbështetje.

Rezultati i pritshëm:

- 10 institucione të përzgjedhura për asistencë teknike, të cilave do t'u ofrohet ndihmë teknike nga MFE;
- Raporte të plota dhe të sakta vjetore në lidhje me kontrollin e brendshëm, të dorëzuar në MFE;
- 10 institucione të përzgjedhura për asistencë teknike që po përdorin njohuritë e marra dhe stilin e ri të menaxhimit në praktikën e përditshme të punës, duke përdorur si mjet, planin e veprimit.

Afati kohor: Afatmesëm

Lidhja me strategjitë sektoriale:

Strategjia e MFP-së: Objektivi specifik 6: Kontroll i efektshëm i brendshëm.

Objektivi i përgjithshëm: Përgjegjësi e efektshme drejtuese, në të gjitha institucionet publike.

Komponenti 6.1: Menaxhimi financiar dhe kontrolli në të gjitha institucionet publike.

Strategjia e RAP: Objektivi 10 "Rritja e efikasitetit dhe përgjegjësisë së nënpunësve publikë"

2.1.2 Objektivi specifik 2: Forcimi i përgjegjshmërisë menaxheriale në njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe përgjegjshmëri e decentralizuar menaxheriale.

Vizioni i qeverisë është të forcojë përgjegjshmërinë menaxheriale, që është një proces ku menaxherët në të gjitha nivelet janë përgjegjës dhe mund t'u kërkohej të shpjegojnë vendimet dhe veprimet e ndërmarra për të përmbushur objektivat e njësisë që menaxhojnë. Menaxheri është gjithashtu përgjegjës për krijimin e të gjitha kushteve të nevojshme paraprake, veçanërisht për funksionimin e efektshëm dhe efektiv të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të siguruar përdorimin e ligjshëm, të qëllimshëm dhe të përshtatshëm të fondeve. Përgjegjshmëria menaxheriale nënkupton përgjegjësinë për menaxhim të fortë financiar në të gjitha nivelet, domethënë organizim, procedura dhe raportim të përshtatshëm të rezultateve të njësisë. Lidhur me këtë propozim, Qeveria ka miratuar udhëzimin nr. 4, datë 29.01.2020 "Për delegimin e detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" dhe ka zgjedhur të njëjtat institucione të përzgjedhura për asistencë teknike për testimin e mënyrës së përdorimit të këtij udhëzimi.

Kjo përgjegjshmëri zbatohet për të gjitha fondet e alokuara buxhetore (nga të gjitha burimet e financimit), edhe kur fondet kalojnë përmes institucionit të nivelit të dytë ose edhe të tretë të përdoruesit të buxhetit. Niveli i parë i përdoruesit të buxhetit merr fonde për të arritur një qëllim specifik (ose qëllime) pasi linja e parë e përdoruesit të buxhetit që do të organizojë përdorimin e këtyre fondeve është përgjegjësi e nivelit të parë.

Është shumë e vështirë për institucionet publike të kuptojnë ose zbatojnë konceptin e përgjegjshmërisë menaxheriale për arsye të ndryshme si:

- keqkuptim i konceptit të përgjegjshmërisë menaxheriale nga drejtuesit;
- menaxherët janë të mbingarkuar për shkak të nevojës për të aprovuar të gjitha vendimet dhe dokumentet që dërgohen jashtë njësisë;
- mungesën e mekanizmave të zhvilluar për transferimin e kompetencave dhe përgjegjësi;
- strukturë të papërshtatshme organizative ose objektivat e njësisë nuk janë të përcaktuara qartë;
- vlerësimi i riskut, i cili duhet të jetë një tipar thelbësor i vendimmarrjes nga niveli drejtues, konsiderohet vetëm si një kërkesë burokratike;
- mungesë informacioni të detajuar (financiar dhe jo-financiar) për analizën e kostos dhe parashikimin e lëvizjeve të tyre në të ardhmen;
- asnjë planifikim strategjik financiar.

Siç u përmend më lart, njësitë e qeverisjes së përgjithshme (qendrore dhe vendore) për zbatimin e përgjegjshmërisë menaxheriale duhet të përdorin instrumentin e decentralizimit të autoriteteve dhe përgjegjësi. Ndarja e përgjegjësi kërkon që të ketë autoritetin dhe burimet e mjaftueshme për të përcaktuar objektivat dhe treguesit e performancës. Duhet të krijohen linja raportimi, duke qenë se menaxherët duhet të raportojnë tek eprrorët e tyre se sa mirë janë kryer përgjegjësitë e deleguara.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një pjesë e procesit të menaxhimit, zbatimi i të cilit është i domosdoshëm për sektorin publik. Të gjithë punonjësit janë përgjegjës për krijimin e një sistemi të fortë të menaxhimit financiar dhe kontrollit, dhe jo vetëm drejtuesit e njësi. Është e nevojshme rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e këtij sistemi përmes strukturave të përshtatshme organizative, duke nënkuptuar përfshirjen e të gjithë punonjësve sipas parimit të ndarjes së detyrave dhe përgjegjësi, përmes një raportimi të rregullt të brendshëm.

Personat përgjegjës për menaxhimin financiar dhe kontrollin në nivelin e përdoruesve buxhetorë duhet të jenë të vetëdijshëm për rolin e tyre në krijimin e një strukture të përshtatshme për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Kjo nuk do të thotë që ata janë përgjegjës për planifikimin

dhe ekzekutimin e buxhetit në nivelin e njësive organizative ose programeve, si dhe për rezultatet e tyre të arritura. Drejtuesit janë përgjegjës për planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit, si dhe për arritjen e rezultateve në nivelin e njësive ose programeve organizative.

Treguesit e rezultateve:

- 75% e institucioneve mund të provojnë se menaxherët kanë autoritet, financim dhe informacion mbi menaxhimin për aktivitetet për të cilat ata janë përgjegjës;
- 100% e institucioneve të përzgjedhura për asistencë teknike kanë krijuar dhe zbatojnë vazhdimisht një sistem të përgjegjësisë menaxheriale, duke përdorur procedurat e delegimit në të gjitha nivelet e menaxherëve;
- 60% e institucioneve mund të provojnë që menaxherët janë njoftuar zyrtarisht për përgjegjësitë e tyre, nivelet e autoritetit, synimet operationale dhe financimin, si dhe mbajtjen e takimeve të rregullta me menaxherët e lartë për të diskutuar performancën;
- 100% e stafit të institucioneve të përzgjedhura për asistencë teknike, marrin pjesë në trajnime dhe seminare, dhe që si rezultat i kësaj asistence janë duke zbatuar ndryshime organizative ose procedurale në institucionet e tyre.

Masa 1: Forcimi i përgjegjshmërisë dhe linjës së raportimit duke përdorur procedurat e delegimit në institucionet e përzgjedhura për asistencë teknike.

Meqenëse procesi i delegimit nuk është zbatuar plotësisht në njësitë e sektorit publik për shkak të mungesës së informacionit të nevojshëm në këtë fushë dhe mungesës së besimit të menaxherëve për të ushtruar këtë të drejtë, kjo masë synon të rrisë ndërgjegjësimin e nivelit të lartë drejtues mbi përfitimet e procedurave të delegimit, si dhe analizën e risqeve dhe raportimin gjatë këtij procesi.

Në kontekstin e përmirësimit të funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha pjesët përbërëse të tij, në përputhje me ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin, MFE ka miratuar udhëzimin për delegimin e detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Meqenëse procesi i delegimit është një nga çështjet kryesore të njësive publike, i identifikuar gjatë monitorimit të kryer, fokusi kryesor i këtij udhëzimi është të përcaktojë qartë termat, rregullat dhe procedurat që do të ndiqen në procesin e delegimit të detyrave brenda njësive publike.

Aktivitetet:

Aktiviteti: 2.1.1 Paraqitja e udhëzimeve për delegimin e detyrave tek njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Institucionet përgjegjëse: MFE (DH/MFKK), Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme

Aktiviteti 2.1.2: Trajnim për institucionet e përzgjedhura për asistencë teknike mbi rëndësinë e përdorimit të instrumentit të delegimit dhe mënyrën e përdorimit dhe kuptimit të udhëzimit të ri për delegimin e të drejtave dhe detyrave.

Institucionet përgjegjëse: MFE (DH/MFKK), institucionet e përzgjedhura për asistencë teknike

Aktiviteti 2.1.3 Ofrimi i asistencës për institucionet e përzgjedhura për asistencë teknike, lidhur me përdorimin e udhëzimeve të delegimit të detyrave;

Institucionet përgjegjëse: MFE (DH/MFKK), institucionet e përzgjedhura për asistencë teknike

Aktiviteti 2.1.4: Ofrimi i asistencës për institucionet e përzgjedhura për asistencë teknike, lidhur me përdorimin e linjës së raportimit në përputhje me autorizimin e deleguar;

Institucionet përgjegjëse: MFE (DH/MFKK), institucionet e përzgjedhura për asistencë teknike.

Rezulti i pritshëm:

- 10 nga institucionet e përzgjedhura për asistencë teknike krijuan dhe zbatojnë vazhdimisht një sistem të përgjegjshmërisë menaxheriale, duke përdorur procedurat e delegimit në të gjitha nivelet e menaxherëve;
- 200 nëpunës publik të trajnuar;
- 10 institucione e përzgjedhura për asistencë teknike do të kenë menaxhim më të mirë të fondeve publike dhe përgjegjësi më të madhe.

Afati kohor: Afatmesëm

Masa 2: Rritja e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollit, si një pjesë integrale e procesit të menaxhimit në sektorin publik.

Qeveria do të kërkojë nga MFE-ja, si ofrues i udhëzimeve metodologjike dhe koordinator i zhvillimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e sektorit publik, kryerjen e aktivitetit të saj funksional përmes strukturës së KBFP-së, duke synuar forcimin e kapaciteteve të menaxherëve dhe stafit tjetër me qëllim zbatimin e kërkesave kryesore në fushën e kontrollit të brendshëm. Në këtë kontekst, trajnimet, seminarët dhe takimet e ndërgjegjësimit janë elementet thelbësore për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Aktivitetet:

Aktiviteti 2.2.1: Organizimi dhe zhvillimi i një konference vjetore rajonale mbi zbatimin e sistemit KBFP, për shkëmbimin e informacionit mbi situatën dhe ndërgjegjësimin për menaxherët e nivelit të lartë;

Institucionet përgjegjëse: MFE (DH / MFKK), Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme

Aktiviteti 2.2.2: Organizimi dhe zhvillimi i trajnimeve për menaxherët në nivelin qendror dhe vendor në lidhje me rolin e tyre në zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, në bazë të rezultateve të treguara në raportet vjetore të paraqitura në MFE.

Institucionet përgjegjëse: MFE (DH/MFKK), Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme

Aktiviteti 2.2.3: Organizimi dhe zhvillimi i seminareve dhe trajnimeve për menaxhimin financiar dhe kontrollin me stafin e institucioneve të nivelit qendror dhe vendor në njësitë me projekte të ndryshme për t'iu paraqitur menaxherëve të nivelit të lartë informacionin që ata duhet të kenë për të hyrë dhe mënyrën si ta përdorin informacionin.

Institucionet përgjegjëse: MFE (DH/MFKK), Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme (Nëpunësit Autorizues)

Rezultati i pritshëm:

- 100 menaxherë të nivelit të lartë të vetëdijshëm dhe që marrin informacionin nga konferencat, seminarët dhe trajnimet e organizuara nga stafi i MFE-së;
- 300 pjesëmarrës në këto seminare dhe trajnime;
- 100 menaxherë të nivelit të lartë të vetëdijshëm për sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit;
- 150 institucione të vetëdijshme për rëndësinë e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Afati kohor: Afatmesëm

Lidhja me strategjitë sektoriale:

Strategjia e MFP: Objektiv i specifik 6: Kontrolli i brendshëm efektiv.

Objektivi i përgjithshëm: përgjegjësi drejtuese e efektshme në të gjitha institucionet publike.

Komponenti 6.1: Menaxhimi financiar dhe kontrolli në të gjitha institucionet publike.

Strategjia e RAP: Objektiv i 10 "Rritja e efikasitetit dhe përgjegjësisë së nëpunësve publikë"

2.1.3 Objektiv i specifik 3: Përmirësimi i procesit të planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit në nivelin qendror dhe vendor, përmes rritjes së rolit të aktorëve të përfshirë në Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe Ekipin e Menaxhimit të Projektit (EMP).

Çdo drejtues i njësive të sektorit publik duhet të krijojë GMS me pjesëmarrjen e nivelit ekzistues të menaxhimit. Grupi i Menaxhimit Strategjik është një element integral i përgjegjësisë dhe qeverisjes publike.

Grupi i Menaxhimit Strategjik luan një rol kryesor në aspektin e integritetit të informacionit financiar dhe të performancës të njësisë publike, sistemit të tij të kontrollit të brendshëm dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për Drejtuesin e njësisë dhe kujdeset për performancën e njësisë publike.

Një Grup i efektshëm i Menaxhimit Strategjik duhet të ketë linja të hapura komunikimi me drejtuesit e njësive, audituesit e brendshëm dhe të jashtëm. GMS-ja duhet të sigurohet se është

furnizuar në kohën e duhur me informacione në një formë dhe cilësi të përshtatshme, për t'i dhënë asaj mundësi të kryejë detyrat në lidhje me të gjitha aktivitetet e njësisë.

Gjithashtu EMP është i rëndësishëm për mirë-funksionimin e GMS-së dhe procesin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit. Menaxherët e programit janë përgjegjës dhe raportojnë, përpara nëpunësit autorizues, mbi hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, mbi përmbushjen e objektivave dhe rezultateve të programit dhe menaxhimin e risqeve të ndërlidhura gjatë procesit të zbatimit të buxhetit.

Drejtuesit e programit janë përgjegjës për të siguruar që përgjegjësitë e ekipit të menaxhimit të programit zbatohen si duhet, si një komponent kyç i organizatës institucionale për përgatitjen e kërkesave buxhetore. Ata kanë përgjegjësinë të organizojnë takime të ekipit të tyre dhe gjithashtu të marrin pjesë në takimet e Grupit të Menaxhimit Strategjik, duke marrë pjesë në secilin diskutim, si dhe në vendimet përkatëse që kanë ndikim në programin e tyre.

Treguesit e rezultateve:

- 80% e institucioneve me mirëfunksionim të GMS dhe EMP pas miratimit të udhëzimeve të rishikuara ku mirëpërcaktohen përgjegjësitë dhe proceset e GMS dhe EMP në procesin e përgatitjes së buxhetit, dhe procesin e ekzekutimit të buxhetit të shoqëruara me gjurmët e auditimit;
- 80% e menaxherëve të programit janë trajnuar për udhëzimet e reja dhe zbatimin e tyre ato si rezultat.

Masa 1: Mirëfunksionimi i Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe Ekipit të Menaxhimit të Projektit (EMP)

Është e rëndësishme të përcaktohen qartë përgjegjësitë drejtuese për EMP dhe GMS dhe procedurat që duhet të ndiqen nga menaxheri i programit në mënyrë që të përmirësohet përgjegjshmëria menaxheriale.

Zbatimi i një sistemi të efektshëm të menaxhimit financiar dhe kontrollit është, ndër të tjera, angazhim i menaxherëve të nivelit të lartë për të përdorur në mënyrë efektive dhe ekonomike burimet financiare në dispozicion. Jo në të gjitha rastet, këta menaxherë kanë informacionin e duhur në lidhje me zbatimin e këtij sistemi. Për të adresuar të gjitha çështjet e identifikuara nga menaxherët operacionalë, duhet të dokumentohet procesi i diskutimit dhe adresimit të këtyre çështjeve në grupin e menaxhimit strategjik dhe ekipet e menaxhimit të programit, duke ndihmuar në marrjen e vendimeve efektive dhe arritjen e objektivave të institucionit.

Aktivitetet:

Aktiviteti 3.1.1: Rishikimi i udhëzimit standard për përgatitjen e buxhetit në bashkëpunim me të dy strukturat (drejtoria përgjegjëse e përgatitjes së buxhetit) për të vendosur procedurat dhe

përgjegjësitë e qarta të EMP dhe GMS në procesin e përgatitjes së buxhetit. (duke përfshirë gjurmët e auditimit);

Institucionet përgjegjëse: MFE, Njësitë e Qeverisjes Qendrore, Institucionet e përzgjedhura për asistencë teknike.

Aktiviteti 3.1.2: Rishikimi i udhëzimit standard për ekzekutimin e buxhetit në bashkëpunim me të dyja strukturat për të qartësuar procedurat dhe përgjegjësitë e EMP dhe GMS, në procesin e ekzekutimit të buxhetit (përfshirë gjurmët e auditimit);

Institucionet përgjegjëse: MFE (DPB dhe DH/MFKK), Njësitë e Qeverisjes Qendrore, Institucionet e përzgjedhura për asistencë teknike.

Aktiviteti 3.1.3: Trajnimi i ekipeve të menaxherit të programit dhe anëtarëve të GMS mbi udhëzimet e reja;

Institucionet përgjegjëse: MFE (DPB dhe DH/MFKK), Njësitë e Qeverisjes Qendrore, Institucionet e përzgjedhura për asistencë teknike.

Aktiviteti 3.1.4: Ofrimi i asistencës për institucionet e përzgjedhura për asistencë teknike në zbatimin e udhëzimeve të reja.

Institucionet përgjegjëse: MFE (DPB dhe DH/MFKK), Institucionet e përzgjedhura për asistencë teknike.

Rezultati i pritshëm:

- Raporti midis fondeve totale të vlerësuara në strategjitë sektoriale dhe fondeve totale të identifikuar për sektorët përkatës brenda PBA-së. Raporti i investimeve të reja publike të paraqitura brenda Ciklit të PBA-së kundrejt investimeve totale të reja publike të aprovuara në një vit;
- Vëllimi total i buxhetit të ekzekutuar përmes AGFIS, në lidhje me shumën totale të buxhetit të ekzekutuar nga pushteti qendror;
- PEFA 22.1. Stoku i shpenzimeve (Detyrimet e prapambetura si përqindje e shpenzimeve totale të vitit fiskal.

Afati kohor: Afatmesëm

Lidhja me strategjitë sektoriale:

Strategjia e MFP: Objektivi specifik 2: Planifikim i mirë-integruar dhe efikas.

Objektivi i përgjithshëm: Alokimi i efektshëm dhe i drejtë i fondeve publike në përputhje me zhvillimin e politikave të sektorit strategjik.

Komponenti:

2.1 Zhvillimi i politikave dhe qeverisje e integruar strategjike;

2.2 Programi buxhetor afatmesëm;

2.3 Planifikimi dhe Mbikëqyrja e Investimeve Publike.

Objektivi specifik 4: Ekzekutimi efikas i buxhetit

Objektivi i përgjithshëm: Sigurimi i përdorimit efikas dhe efektiv të burimeve të miratuara buxhetore.

Komponenti: Kontrollat shumëvjeçare të angazhimit dhe llogaritë e pagueshme.

2.2 Menaxhimi i riskut

2.2.1 Objektivi specifik 4: Përcaktimi i mekanizmave të mirë-organizuar dhe funksional të procesit të menaxhimit të riskut

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e aktiviteteve ose situatave të mundshme që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësisë publike dhe është krijuar për të dhënë një siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen.

Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrje me cilësi të mirë, parashikim dhe optimizim më të mirë të burimeve të disponueshme, trajtimin e përparësive dhe shmangien e problemeve në të ardhmen që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të përcaktuara.

Qëllimi i procesit të menaxhimit të riskut nuk është eliminimi i riskut, por zvogëlimi i tij në një nivel të pranueshëm. Procesi i menaxhimit të riskut ndihmon menaxherët në perceptimin e procesit të përgjithshëm të identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të risqeve të mundshme, duke marrë parasysh objektivat e përcaktuara të përdoruesve të buxhetit. Kusht për menaxhimin e riskut është kryerja e një vlerësimi të përditësuar të deklaratës së misionit të njësisë, objektivave specifike dhe të përgjithshme në të gjitha nivelet, si dhe ndërmarrja e veprimeve të nevojshme, veçanërisht përmes menaxhimit financiar dhe kontrollit. Menaxhimi i riskut është një proces i vazhdueshëm dhe jo vetëm një ushtrim vjetor. Kërkohet gjykim i fortë dhe madje edhe menaxherët më me përvojë mund të menaxhojnë keq riskun, duke e nënvlerësuar ose mbivlerësuar atë, por gjithsesi është një pjesë thelbësore e rolit të një menaxheri.

Lidhur me procesin e menaxhimit të riskut, dokumente të tilla si regjistri i riskut dhe strategjia e riskut nuk janë përdorur ende si një instrument që ndihmon nivelin drejtues në arritjen e objektivave ose auditimin e brendshëm në identifikimin e fushave me risk më të lartë. Gjithashtu, një çështje tjetër e rëndësishme mbetet që risqet e larta në institucionet përkatëse nuk janë objekt diskutimi në Grupet e Menaxhimit Strategjik.

Treguesit e rezultateve:

- 75% e institucioneve mund të identifikojnë ndryshimet e bëra (p.sh. në proceset ose alokimin e burimeve) për të ndihmuar arritjen e objektivave si rezultat i informacionit të përditësuar mbi risqet që raportohen dhe diskutohen në çdo takim të GMS-së (me veprimet pasuese që do të ndërmerren për ndjekjen e tyre, duke i përcaktuar edhe në minutat e takimit).

Masa 1: Zhvillimi i mëtejshëm i Procesit të Menaxhimit të Riskut

Menaxhimi i riskut është një komponent shumë i rëndësishëm për arritjen e objektivave të njësisë publike dhe një pjesë integrale e të gjithë procesit të menaxhimit. Zhvillimi dhe përmirësimi i mëtejshëm i këtij procesi duhet të integrohet në kulturën e organizatës dhe të përfshijë menaxhim të nivelit të lartë si dhe stafin e njësisë publike. Zhvillimi i këtij procesi duhet të shndërrojë strategjinë e riskut në objektiva taktikë dhe operacionalë, si dhe të përcaktojë ndarjen e përgjegjësi të menaxhimit të riskut në të gjithë njësinë publike.

Aktivitetet:

Aktiviteti 4.1.1: Zhvillimi i regjistrit të riskut dhe strategjisë së riskut me përdoruesit e buxhetit në nivelin qendror dhe vendor, si pjesë integrale e procesit të menaxhimit të njësinë publike.

Institucionet përgjegjëse: MFE (DH/MFKK), Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme

Aktiviteti 4.1.2: Integrimi i sistemit të menaxhimit të riskut në procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes.

Institucionet përgjegjëse: MFE (DH/MFKK), Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme

Aktiviteti 4.1.3: Çështjet e menaxhimit të riskut të diskutuara në takimet e GMS-së.

Institucionet përgjegjëse: MFE (DH/MFKK), Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme

Rezultati i pritshëm:

- 110 institucione që kanë krijuar një grup të menaxhimit të riskut në nivelin institucional;
- 110 institucione që kanë aprovuar regjistrin e riskut dhe strategjinë e riskut;
- 110 institucione që kanë zhvilluar dhe zbatojnë një Strategji të Menaxhimit të riskut si pjesë e takimeve të rregullta të nivelit drejtues.

Afati kohor: **Afatmesëm**

Lidhja me strategjitë sektoriale:

Lidhja me strategjitë sektoriale:

Strategjia e MFP-së: Objektivi specifik 6: Kontrolli i brendshëm efektiv.

Objektivi i përgjithshëm: Përgjegjësia efektive drejtuese në të gjitha institucionet publike.

Komponenti 6.1: Menaxhimi financiar dhe kontrollit në të gjitha institucionet publike.

Strategjia e RAP: Objektiv 10 "Rritja e efikasitetit dhe përgjegjësisë së nëpunësve publikë"

2.3 Informimi dhe komunikimi

2.3.1 Objektiv specifik 5: Përmirësimi i fushës së kontabilitetit të sektorit publik në Shqipëri

Sistemet e zhvilluara të kontabilitetit për qëllime të raportimit të brendshëm, ose për nevojat e menaxhimit financiar dhe kontrollit përfshijnë kryerjen e analizës së kostos në institucionin qendror dhe deri në nivelin e njësisë shpenzuese.

Një analizë gjithëpërfshirëse deri në nivelin e njësisë shpenzuese do të sigurojë lidhjen midis planit të fondeve të miratuara nga buxheti dhe objektivave të përcaktuara me rezultatet e arritura, të cilat përfundimisht do të rezultojnë në identifikimin e devijimeve dhe dobësive të caktuara të instrumentave të raportimit të brendshëm.

Republika e Shqipërisë aktualisht nuk ka standarde të kontabilitetit të sektorit publik. Në vend të kësaj, Parimet e Përgjithshme të Pranuara të Kontabilitetit të Sektorit Publik Shqiptar (PPPK SP) janë kodifikuar në një kuadër ligjor kompleks, të fragmentuar dhe të paqartë. Kryesisht, veprohet mbi bazë cash-i në kontabilitet me disa elemente accrual për disa kategori specifike të aktiveve dhe pasiveve. Kjo bazë kryesisht cash-i i kontabilitetit së bashku me kontrole jo shumë efektive të brendshme ka kontribuar në një akumulim të konsiderueshëm të detyrimeve të prapambetura që janë duke shkaktuar një stres të konsiderueshëm fiskal.

Qeveria e Shqipërisë është e angazhuar në implementimin gradual të një sistemi modern të kontabilitetit të sektorit publik bazuar në standardet ndërkombëtare. Në përputhje me Strategjinë e MFP-së së Shqipërisë, qeveria dëshiron të bëjë një kalim gradual në kontabilitetin mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP). Ndërkohë që është arritur progres në zhvillimin e sistemeve të TI, qasjet moderne të kontabilitetit në sektorin publik janë në fillimet e tyre. Aktivitetet dhe detyrimet, si dhe të ardhurat dhe shpenzimet, nuk janë raportuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe sistemi aktual nuk ka të dhëna të rëndësishme për angazhimet dhe detyrimet e prapambetura. Mungesa e të dhënave lidhet kryesisht me nivelin e ulët të kapaciteteve profesionale të stafit, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal; për më tepër, raportimi financiar nga institucionet ekstra buxhetore sigurohet mbi baza *ad-hoc* dhe transaksionet e tyre nuk pasqyrohen në Sistemin e Thesarit (AFMIS). Informacionet shpjeguese në pasqyrat financiare janë elementare dhe kanë nevojë për zhvillim të mëtejshëm. Përgatitja në të ardhmen e pasqyrave financiare të dobishme varet nga zhvillimi i një sistemi gjithëpërfshirës të TI dhe standardeve praktike të kontabilitetit, të cilat përgatiten në përputhje me normat ndërkombëtare.

Treguesit e rezultateve:

- 75% e 7 Institucioneve të përzgjedhura për asistencë teknike mund të identifikohen si shembuj të vendimmarrjes më të mirë në bazë të informacionit më të saktë financiar të dhënë.

Masa 1: Forcimi i standardeve të kontabilitetit dhe raportimit në njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore

Qëllimi kryesor i forcimit të kontabilitetit dhe raportimit financiar në sektorin publik është të përmirësojë menaxhimin e fondeve buxhetore, të përmirësojë vendimmarrjen dhe transparencën e përgjithshme të përdorimit të burimeve fiskale, duke implementuar gradualisht një sistem të kontabilitetit të sektorit publik bazuar në standardet ndërkombëtare dhe të përmirësojë kapacitetin institucional për të përgatitur dhe shfrytëzuar informacionin financiar. Informacioni i saktë i raportimit financiar në sektorin publik është themeli i një sektori publik që funksionon mirë dhe në zemër të një sektori publik që jep vlerë për para. Përmirësimi i cilësisë së informacionit të raportimit financiar në Shqipëri do të ketë një ndikim të rëndësishëm dhe pozitiv për qytetarët e Shqipërisë dhe për komunitetin e gjerë ndërkombëtar.

Aktivitetet:

Aktiviteti 5.1.1: Zhvillimi i angazhimeve institucionale udhëzuese kombëtare dhe planit afatgjatë të veprimit për tranzicionin nga kuadri ekzistues i kontabilitetit dhe raportimit financiar të sektorit publik, në përputhje me zhvillimin e sistemit të thesarit (AGFIS) në AFMIS;

Institucionet përgjegjëse: MFE, Parlamentarë, Vëzhgues të Pavarur: Kontrolli Lartë i Shtetit, INSTAT;

Aktiviteti 5.1.2: Zhvillimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor në fushën e sistemeve të kontabilitetit për sektorin publik;

Institucionet përgjegjëse: MFE, Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme

Aktiviteti 5.1.3: Kapaciteti teknik i përmirësuar i Njësisë së Raportimit Financiar të MFE (përgjegjës për zbatimin e rregullave të Kontabilitetit Publik) dhe Njësisë Qendrore të Harmonizimit (përgjegjës për metodologjinë e Kontabilitetit Publik) në përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar të sektorit publik në përputhje me standardet ndërkombëtare;

Institucionet përgjegjëse: MFE, Ministrinë e Linjës dhe agjencitë mbështetëse, PAO

Aktiviteti 5.1.4: Zhvillimi i një kualifikimi të qëndrueshëm të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me praktikatat e mira ndërkombëtare; dhe kuptimi dhe zbatimi i përmirësuar i standardeve përkatëse të kontabilitetit nga praktikuesit dhe audituesit e sektorit publik;

Institucionet përgjegjëse: MFE, Ministrinë e Linjës dhe agjencitë mbështetëse, PAO, ASPA, Universitetet

Aktiviteti 5.1.5: Ndërgjegjësim më i madh mbi përfitimet e kontabilitetit dhe raportimit financiar të sektorit publik të përmirësuar nga palët e interesuara (zyrtarë të qeverisë, politikanë, media dhe organizata të shoqërisë civile).

Institucionet përgjegjëse: MFE

Rezultati i pritshëm:

- Është hartuar dhe përdoret plani i ri i llogarive;
- Akte të reja ligjore dhe nënligjore në fushën e kontabilitetit të sektorit publik;
- 100% e 42 SNKSP janë përkthyer dhe publikuar në faqen zyrtare të MEF;
- 5 trajnime dhe seminare që janë organizuar me qëllim të përmirësimit të kapacitetit teknik të stafit të MEF;
- 100% e 100 punonjësve të trajnuar të financave dhe kontabilitetit në institucionet e qeverisjes qendrore mbi kontabilitetin e sektorit publik dhe raportimin financiar të bazuar në SNKSP;
- 100% e 7 institucioneve të përzgjedhura për asistencë teknike që përgatitnin pasqyra financiare të konsoliduara me të njëjtën bazë krahasuese.

Afati kohor: **Afatmesëm- Afat gjatë**

Lidhja me strategjitë sektoriale:

Strategjia e MFP:

Objektivi specifik 5: Transparenca e financave publike

Objektivi i përgjithshëm.

Përmirësimi i mbulimit, cilësisë dhe aksesit të informacionit mbi financat publike.

Komponenti 5.4: Kontabiliteti

Objektivi: Kontabiliteti është në përputhje me Standardet e duhura Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik.

Komponenti 5.5: Përmirësimi i menaxhimit të aktiveve

Objektivi: Përgatitja dhe publikimi i regjistrit të plotë të aktiveve të sektorit publik, bazuar në rregulloret e përmirësuara për vlerësimin dhe inventarizimin e këtyre pasurive.

Komponenti 5.1: Llogaritë Kombëtare të Qeverisë

Objektivi: Statistikat Financiare të Qeverisë në kohë dhe të besueshme.

Komponenti 5.2: Monitorimi dhe raportimi financiar dhe i performancës

Objektivi: Raportet financiare të publikuar çdo vit përmbajnë informacion të performancës financiare dhe jo-financiare.

Objektivi specifik 4: Ekzekutimi efikas i buxhetit

Objektivi i Përgjithshëm.

Sigurimi i përdorimit efikas dhe efektiv të fondeve buxhetore të miratuara.

Komponenti 4.2 Kontrollat e angazhimeve shumëvjeçare dhe llogaritë e pagueshme

Objektivi: Angazhimet afatmesme kontrollohen në mënyrë gjithëpërfshirëse brenda kufijve të vendosur nga Qeveria dhe Parlamenti përmes Buxhetit dhe ligjeve, rregulloreve dhe udhëzimeve përkatëse.

2.3.2 Objektivi specifik 6: Vendosja e një sistemi eficient dhe efektiv të informimit dhe komunikimit.

Për mirëqeverisje nevojiten flukse efikase të informacionit midis njësive, p.sh. midis ministrive të linjës dhe MFE-së ose nga një njësi varësie tek Ministria e tyre mëmë. Informacioni duhet t'i komunikohet nivelit drejtues, punonjësve të tjerë dhe palëve të treta që kanë nevojë për informacionin në një formë dhe brenda një afati kohor, që i ndihmon ata të kryejnë përgjegjësitë e tyre, gjithashtu edhe në lidhje me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm. Komunikimi me klientët, furnizuesit, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është thelbësor për një kontroll të brendshëm efektiv. Informacioni është baza për komunikimin e nevojshëm për zbatimin efikas të detyrave të caktuara.

Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit përmes të cilave informacioni transferohet mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit për sa i përket afateve kohore, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërisë së tyre.

Treguesi i rezultateve:

- 100% e institucioneve të përzgjedhura për asistencë teknike mund të demonstronë përfitimet nga informacioni dhe sistemeve të komunikimit të përmirësuara, përmes performancës së përmirësuar financiare ose operacionale;
- 100% e menaxherëve brenda institucionit e marrin informacionin që u nevojitet për të përmbushur përgjegjësitë e tyre.

Masa 1. Vendosja e një linje të qartë raportimi që do të lejojë informacion të rregullt, kuptimplotë, gjithashtu të shpejtë dhe të saktë të menaxhimit mbi kostot, efikasitetin, cilësinë dhe rezultatet e arritura në drejtim të objektivave.

Komunikimi përfshin shkëmbimin e informacionit të dobishëm midis personave dhe strukturave për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet. Informacioni është baza e komunikimit të nevojshëm për kryerjen efektive të detyrave të caktuara dhe komunikimin e rezultateve të arritura në shkallën e duhur hierarkike, në mënyrën dhe kohën e duhur. Kjo masë synon zyrtarizimin e linjave të shpejta dhe të sakta të raportimit dhe formatet standarde të informacionit të përcjellë, një proces ky që mbetet ende një sfidë për mirë funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike.

Aktiviteti 6.1.1: Institucionet e përzgjedhura për asistencë teknike vendosin një linjë të qartë raportimi, që do të lejojë informacion dhe komunikim të rregullt dhe kuptimplotë të nivelit drejtues me ndihmën e MFE-së.

Institucionet përgjegjëse: MFE (DH/MFKK) dhe institucionet e përzgjedhura për asistencë teknike.

Rezultati i pritshëm:

- 10 institucione e përzgjedhura për asistencë teknike mund të tregojnë përfitimet e përmirësimit të sistemeve të informacionit dhe komunikimit përmes performancës së përmirësuar financiare ose operacionale.

Afati kohor: Afatmesëm

Lidhja me strategjitë sektoriale:

Strategjia e MFP: Objektivi specifik 6: Kontrolli i brendshëm efektiv.

Objektivi i përgjithshëm: përgjegjshmëria efektive drejtuese në të gjitha institucionet publike.

Komponenti 6.1: Menaxhimi financiar dhe kontrollit në të gjitha institucionet publike.

Strategjia e RAP: Objektivi 10 "Rritja e efikasitetit dhe përgjegjësisë së nëpunësve publikë".

2.4 Aktivitetet e kontrollit

2.4.1 Objektivi specifik 7: Aktivitete kontrollit nëpërmjet dokumentimit të sistemit të MFK përmes Hartës/manualeve të Proceseve të punës dhe Gjurmëve të Auditimit

